

## UNIVERSITETI TETOVËS FAKULTETIT EKONOMIK

Në bazë të nenit 110 dhe 173 të Ligjit për Arsimin e Lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 82/2018“), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, dhe nenit 158 të Statutit të Universitetit të Tetovës dhe në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje – rizgjedhje të mësimdhënësve në thirrje mësimore – shkencore në Universitetin e Tetovës si dhe në bazë të Propozimit të Këshillit Mësimor të Fakultetit Ekonomik, në webfaqen [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk) dhe në gazetën ditore “Koha” dhe “Nova Makedonija” më datë 05.11.2021 shpall konkurs për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin e Financave dhe Bankave (50326, 50321 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

Bazuar në këtë konkurs Këshilli – Mësimor Shkencor i Fakultetit Ekonomik, në mbledhjen e mbajtur më datë 16.12.2021, solli Vendim me Nr.14-1241/4 për formimin e Komisionit Recensues për zgjedhje-rizgjedhje të mësimdhënësit në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin e Financave dhe Bankave (50326, 50321 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në përbërje:

1. Prof. Dr. Ibish Mazreku – kryetar, profesor ordinar, Fakulteti Ekonomik, Universiteti Haxhi Zeka, Pejë, Republika e Kosovës
2. Prof. Dr. Alifeta Selimi – anëtar, profesor ordinar, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës, Tetovë
3. Prof. Dr. Sabahudin Komoni – anëtar, profesor ordinar, Fakulteti Ekonomik, Universiteti Hasan Prishtina, Prishtinë, Republika e Kosovës

Pas marrjes së konfirmimit se jemi anëtar të Komisioni Recensues, të zgjedhur prej Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tetovës për të shqyrtuar dhe për të vlerësuar krijimtarinë shkencore e profesionale dhe veprimtarinë shkencore të kandidatit Prof. Dr. Afrim Alili, që ka konkurruar në konkursin e shpallur në webfaqen [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk) dhe në gazetën “Koha” dhe “Nova Makedonija” më 05.11.2021 për mësimdhënësi në lëmin e Financave dhe Bankave (50326, 50321 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) kemi kënaqësinë të paraqesim këtë:

### R E F E R A T

PËR ZGJEDHJEN E NJË MËSIMDHËNËSI NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE  
PROFESOR ORDINAR NË FAKULTETIN EKONOMIK NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Me datë 05.11.2021 në webfaqen [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk) dhe gazetën “Koha” dhe “Nova Makedonija” është shpallur konkurs për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi në Fakultetin

Ekonomik në lëmin e Financave dhe Bankave (50326, 50321 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

Komisioni në fjalë, pasi kontrolloi materialet e dorëzuara, konstatoi se në Konkurs si kandidat i vetëm është paraqitur Prof. Dr. Afrim Alili i punësuar në marrëdhënie të rregullt pune, si **Profesor inordinar** në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës.

## I. TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

### A. Të dhënat themelore

Kandidati Prof. dr. Afrim Alili është i lindur më datë 15.12.1962 në Gostivar, Republika e Maqedonisë. Shkollën fillore dhe të mesme Gjimnazin Pançe Popovski me sukses të shkëlqyeshëm i ka mbaruar në vitin 1981 në Gostivar. Pas diplomimit të tij, me sukses mesatar 8.30 në vitin 2001, është regjistruar në studime pas diplomike në drejtimin ekonomi dhe biznes në Fakultetin ekonomik në kuadër të Universitetit Shën Shën Kirili dhe Metodi, në V. Tërnovë. Gjatë studimeve të tija, kandidati ka treguar rezultate të mirëfillta në lëndët nga fushat e: kontabilitetit, financave dhe revizionit, në kuadër të subjekteve mezo-ekonomike dhe mikro-ekonomike.

Pasi që i ka mbaruar të gjithë provimet e parapara me plan programin mësimor në këtë studium pas studimor me notë mesatare 5.23<sup>1</sup>ka paraqitur, përgatitë dhe më datë 30.06.2003 me sukses të shkëlqyeshëm ka mbrojtur tezën e magjistraturës në temë: Teknologjitë e internetit për përkrahje informative të ndërmarrjes ALFA përpara komisionit në përbërje: Prof. dr. Lazar Lazarov, Prof. dr. Konstantin Ivanov dhe Prof. dr. Najden Najdenov.

Në janar të vitit 2005, kandidati Prof. dr. Afrim Alili është regjistruar në studime të doktoraturës në Fakultetin ekonomik pranë universitetit Shën Shën Kirili dhe Metodi, në drejtimin financa, kontabilitet, banka dhe sigurim. Disertacionin e tij të doktoraturës me temë: **Menaxhimi e rrezikut të kredisë në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë**, kandidati dr. Afrim Alili e ka përgatitur në udhëheqjen e mentorit Prof. dr. Pavlin Ivanov.

Më konkretisht, pasi që disertacioni ka qenë lëndë e mbrojtjes së suksesshme në kuadër të dy fazave paraprake, Komisioni i Lartë për Atestim më datë 13.10.2009, në bazë të raporteve recensuese për mbrojtjen e suksesshme, ka sjellë vendim për kandidatin që të promovohet në **Doktor i shkencave të ekonomisë**, në drejtimin financa, kontabilitet, qarkullim monetar, kredi dhe sigurim. Kandidati dr. Afrim Alili, me fletëparaqitjen ka dorëzuar dhe Vendim për nostrifikimin, me çfarë i pranohet kualifikimi i arsimit sipëror i fituar jashtë vendit, si dokument për pranimin e mbarimit të ciklit të tretë të studimeve të doktoraturës dhe thirrja e fituar shkencore **Doktor i shkencave të ekonomisë**.

### B. Marrja e thirrjeve mësimore

---

<sup>1</sup> Sipas metodologjisë së notimit në R. e Bullgarisë prej 2 deri në 6.

Në vitin akademik **2004/2005**: është zgjedhur asistent për lëndën **Ekonomia e ndërmarrjeve** në Fakultetin ekonomik pranë USHT-së,

Në vitin akademik **2010/2011** (Qershor 2010) është zgjedhur në thirrjen mësimore-shkencore **Docent** për lëndët **Bankat dhe punët bankare dhe Financat e korporatave** në Programin studimor Financa dhe kontabilitet, Fakulteti ekonomik, USHT.

Në vitin akademik 2015/2016 (Maj 2016) është zgjedhur **profesor inordinar** për lëndët **Bankat dhe punët bankare dhe Financat e korporatave** në Programin studimor Financa dhe kontabilitet, Fakulteti ekonomik, Universiteti i Tetovës.

## **II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE**

Gjatë viteve akademike të periudhës 2016-2021 në Fakultetin ekonomik Prof. dr. Afrim Alili ka ligjëruar lëndët në ciklin e parë të studimeve: Bazat e ekonomisë, Mikroekonomi I, Bankat dhe punët bankare, Financat e korporatave, Financat e korporatave për Informatikë, Menaxhmenti bankar, Analiza e raporteve financiare, Tregjet dhe institucionet financiare dhe Teoria dhe analiza e bilancit. Në ciklin e dytë të studimeve: Punët bankare bashkëkohore, Tregjet financiare ndërkombëtare dhe Financat ndërkombëtare dhe bankat. Ndërsa në ciklin e tretë (Studime të doktoraturës) lëndët: Trendet bashkëkohore bankare dhe Politika monetare.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidati Prof. dr. Afrim Alili ka realizuar gjithsejtë 184 pikë nga veprimtaria mësimore-arsimore.

## **III. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE**

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidati është marrë vazhdimisht me realizimin e veprimtarisë hulumtuese shkencore në fushën e shkencave ekonomike, gjegjësisht në lëmin e financave.

Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrje në tubime shkencore. Kjo veprimtari e kandidatit është paraqitur si më poshtë:

### **A. Artikuj shkencorë**

1. Alili Imërlije, **Alili Afrim**, Relationship between water pollution and economic growth in Republic of Kosova, International journal “Knowledge”, Vol.43.3, **ISSN: 1857-923X (Printed), ISSN : 2545-4439 (Online)**, pp.515-521, 2020

2. Alili Sulejmani, Liza, Velickovska, Kristina & **Alili, Afrim**: The macroeconomic approach of the Pandemic COVID - 19, Trends in Economics, Finance and Management Journal, Vol. 2, Issue 1, 2020.
3. Alili Sulejmani, Liza & **Alili Afrim**: The nexus between institutional factors and foreign direct investments in developing countries in Europe, Knowledge International Journal 31 (1), 23-26, 2019.
4. Alili Sulejmani, Liza, **Alili, Afrim**: Nexus trade openness, FDI and economic growth in Republic of Macedonia: VECM approach, InTraders International Conference on International Trade Conference Book, pp. 500 – 512, 2018.
5. Alili Sulejmani, Liza., Bilic, Snezana & **Alili, Afrim.**: “The Impact of Distortionary Taxes on Economic Growth: Case of Republic of Macedonia”, International journal “Knowledge”, Vol.20.1, ISSN2545 – 4439, ISSN 1857 923X, pp.483-486, 2017.
6. **Alili, Afrim**, Alili Sulejmani, Liza, & Krалеva, Natasa.: “Econometric Analysis of the Impact of Productive and Unproductive Expenditures on Economic Growth: Case of Republic of Macedonia, International journal “Knowledge”, Vol.20.1, ISSN2545 – 4439, ISSN 1857 923X, pp.253-259, 2017.
7. Alili Imërlije, **Alili Afrim**, Effects of climatic change factors in agricultural production Case of Republic of Macedonia, International Journal Institute of Knowledge Management, Vol. 20.5, Skopje, 2017
8. **Alili, Afrim**, Relationship and causality between interest rate and inflation rate: Case of Republic of Macedonia, International Journal Scientific Papers, Knowledge, Vol. 15.3, Skopje, 2016

## **B. Tubime shkencore**

1. Contemporary Economic Trends” – CET2019, organized by: Faculty of Economics & Faculty of Business Administration, University of Tetova, 13 – 15 November, 2019 at University of Tetova, Macedonia.
2. InTraders International Conference on International Trade, The impact of the variability of requirement reserves on banking system financial intermediation, 04-06 October 2018, Sakarya, Turkey
3. Konferenca e 11 shkencore, Kolegji Biznesi, Marrëdhënia dhe ndërveprimi midis zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit të emergjencave, Menaxhimi emrgjen me efektet e zhvillimit ekonomik dhe ndotjen e mjedisit uxor në Republikën e Kosovës, Prishtinë, 25. 10.2018
4. InTraders International Conference on International Trade, 10-12 May 2018, Sakarya, Turkey
5. Effects of climatic change factors in agricultural production Case of Republic of Macedonia, Knowledge in Practice, Eleventh International Scientific Conference, Bansko, 15-17 December 2017

6. ICOS2017, International Conference on Official Statistics, Sarajevo, BiH, Causal impact of Public Revenues and Public expenditures in Republic of Macedonia, Sarajevo, March 2016, Bosnia and Hercegovina
7. Knowledge in Practice, Eleventh International Scientific Conference, Relationship and causality between interest rate and inflation rate: Case of Republic of Macedonia, Bansko, 16-18 December 2016
8. Efektet e proceseve migruese në Ballkanin Perëndimor, Konferenca e katërt shkencore e Fakultetit Ekonomik, 02 Dhjetor, USHT, Tetovë 2016
9. Challenges of doing business in the contemporary World, Konferenca e pestë shkencore e Fakultetit Ekonomik, USHT, Tetovë 2017
10. Economic development as prediction for EU integration, Konferenca e gjashtë shkencore e Fakultetit Ekonomik, USHT, Tetovë 2018

### **C. Projekte**

Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, Komisioni recensues konstaton veprimtarinë hulumtuese-shkencore në periudhën e kaluar që është me rëndësi esenciale për vlerësimin e kandidatit për veprimtarinë hulumtuese-shkencore.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin të Tetovës (Buletini i i universitetit), kandidati Prof. Dr. Afrim Alili ka realizuar gjithsejtë 74.2 pikë nga veprimtaria shkencore-hulumtuese.

### **IV. VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE**

- Anëtar në komisionin për përgatitjen e elaboreve të programeve studimore të ciklit të parë të Fakultetit Ekonomik;
- Anëtar në komisionin për përgatitjen e elaboreve të programeve studimore të ciklit të dytë të Fakultetit Ekonomik;
- Anëtar në komisionin për përgatitjen e elaboreve të programeve studimore të ciklit të tretë të Fakultetit Ekonomik;
- Promovim i Fakultetit Ekonomik për vitet akademike: 2016/2017; 2017/2018 dhe 2018/2019

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën e zgjedhjes në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin Shtetëror të Tetovës (Buletini i universitetit), kandidati Prof. Dr. Afrim Alili ka realizuar gjithsej 13 pikë nga veprimtaria profesionale-aplikative.

#### **V. VEPRIMTARIA NGA INTERESI MË I GJËRË**

- Anëtar i këshillit organizues të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare të Fakultetit Ekonomik 2016/2017; 2017/2018, Universiteti i Tetovës
- Anëtarë i komisionit për rangim të studentëve në nivel universitar, për vitet akademike 2016/2017; 2017/2018; 2018/2019, në Universiteti e Tetovës
- Anëtarë komisioni në Fakultetit Ekonomik për ciklin e parë të studimeve dhe për ciklin e dytë, Universiteti i Tetovës

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidati Prof. Dr. Afrim Alili ka realizuar gjithsej 11 pikë nga veprimtaria me interes më të gjerë.

#### **FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE**

Në shtojcat e mëposhtme është bashkangjitur formulari për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati Dr. Afrim Alili ka grumbulluar gjithsej 282.2 pikë, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-arsimore 184 pikë, veprimtarinë shkencore-hulumtuese 74.2 pikë, veprimtarinë profesionale-aplikative 13 pikë dhe veprimtarinë me interes më të gjerë 11 pikë.

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATES PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE</b>	<b>PIKË</b>
VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	184
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	74.2

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	13
VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJËRË	11
<b>Gjithsej</b>	<b>282.2</b>

## PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të pasqyrës së prezantuar më lartë, si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni Recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidati Prof. Dr. Afrim Alili në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), ka grumbulluar gjithsej 284 pikë nga referencat profesionale, me këtë e ka tejkaluar numrin minimal të pikëve që duhet të realizohen, për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **profesor ordinar**.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit, Komisioni Recensues konstaton se: Prof. Dr. Afrim Alili posedon cilësi shkencore-profesionale dhe në bazë të Ligjit për Arsim të Lartë të Republikës së Maqedonisë e Veriut, në përputhje me Rregulloren për kriteret e veçanta për procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin të Tetovës, ai i plotëson të gjitha kushtet për t'u zgjedhë në thirrjen që ka konkurruar.

Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, që kandidati Prof. Dr. Afrim Alili të zgjidhet në thirrjen mësimore shkencore **PROFESOR ORDINAR** në lëmin e Financave, Bankave (50326, 50321 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

Tetovë, Dhjetor 2021

Komisioni recensues:

1. Prof. Dr. Ibish Mazreku

---

2. Prof. Dr. Alifeta Selimi

---

3. Prof. Dr. Sabahudin Komoni

---

## SH T O J C Ë

### PËR RECENSIONIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

**Kandidati:** Afrim Jakub Alili

(emri, emri i prindërit dhe mbiemri)

**Institucioni:** Fakulteti Ekonomik-UT, Tetovë

(emri i fakultetit/institucioni)

**Lëmi shkencor:** Financa, kontabilist dhe banka

## I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Mbajtja e ligjëratave në ciklin e parë			
	Aktiviteti	Kalkulimi	Pikët
<b>Viti akademik 2016/2017</b>			
	Bazat e ekonomisë (Ekonomik: Financa-kontabilitet) Sem. I, 4+2	4 x 15 x 0.04	2.4
	Bazat e ekonomisë (Ekonomik: Ekonomi-biznes/ Shkup) Sem. I, 2+2	2 x 15 x 0.04	1.2
	Bazat e ekonomisë (Juridik: Gazetari) Sem. I, 2+2	2 x 15 x 0.04	1.2
	Financat e korporatave (Ekonomik: Financa-kontabilitet) Sem. VII 3+2	2 x 15 x 0.04	1.2
	Mikroekonomi I (Ekonomik: Financa-kontabilitet) Sem. II 4+2	4 x 15 x 0.04	2.4
	Bankat dhe punët bankare	2 x 15 x 0.04	1.2

	(Ekonomik: Financa-kontabilitet), Sem. VI 2 +2		
	Vendosja biznesore (Ekonomik: Ekonomi-biznes/ Shkup) Sem. I, 2+2	2 x 15 x 0.04	1.2
		<b>Gjithsej</b>	<b>10.8</b>
<b>1.2. Viti akademik 2017/2018</b>			
	Bazat e ekonomisë (Ekonomik: Financa-kontabilitet) Sem. I, 4+2	4 x 15 x 0.04	2.4
	Financat e korporatave (Ekonomik: Financa-kontabilitet) Sem. VII 2+2	2 x 15 x 0.04	1.2
	Bazat e ekonomisë (Juridik: Gazetari) Sem. I, 2+2	2 x 15 x 0.04	1.2
	Bazat e ekonomisë (Ekonomik: Ekonomi-biznes/ Shkup) Sem. I, 2+2	2 x 15 x 0.04	1.2
	Mikroekonomi I (Ekonomik: Financa-kontabilitet) Sem. II 4+2	4 x 15 x 0.04	2.4
	Bankat dhe punët bankare (Ekonomik: Financa-kontabilitet), Sem. V 2 +2	2 x 15 x 0.04	1.2
	Menaxhment financiar (Ekonomi-biznes/Shkup) Sem. VI, 2+2	2 x 15 x 0.04	1.2
	Vendosja biznesore (Ekon.: Ekonomi-biznes/Shkup) Sem VI, 2+2	2 x 15 x 0.04	1.2
		<b>Gjithsej</b>	<b>12</b>
<b>1.2. Viti akademik 2018/2019</b>			
	Bazat e ekonomisë (Ekonomik: Financa-kontabilitet) Sem. I, 4+2	4 x 15 x 0.04	2.4
	Financat e korporatave (Ekonomik: Financa-kontabilitet) Sem. VII	2 x 15 x 0.04	1.2
	Bankat dhe punët bankare (Ekonomik: Financa-kontabilitet), Sem. V 2 +2	2 x 15 x 0.04	1.2
	Mikroekonomi I (Ekonomik: Financa-kontabilitet) Sem. II 4+2	4 x 15 x 0.04	2.4
	Menaxhimi bankar (Ekonomik: Ekonomi-biznes) Sem. VIII 2+2	2 x 15 x 0.04	1.2
	Analiza e raporteve financiare (Ekonomik: Financa-kontabilitet), Sem. VII 3 +2	3 x 15 x 0.04	1.8
		<b>Gjithsej</b>	<b>10.2</b>
<b>1.2. Viti akademik 2019/2020</b>			
	Financat e korporatave (Ekonomik: Financa-kontabilitet) Sem. VII	2 x 15 x 0.04	1.2
	Bankat dhe punët bankare (Ekonomik: Financa-kontabilitet), Sem. V 2 +2	2 x 15 x 0.04	1.2
	Bazat e ekonomisë (Ekonomik: Financa-kontabilitet) Sem. I, 4+2	4 x 15 x 0.04	2.4
	Menaxhimi bankar (Ekonomik: Ekonomi-biznes) Sem. VIII 2+2	2 x 15 x 0.04	1.2

	Analiza e raporteve financiare (Ekonomik: Financa-kontabilitet), Sem. VII 3 +2	3 x 15 x 0.04	1.8
	Tregjet dhe institucionet financiare (Ekonomik: Financa-kontabilitet), Sem. VIII 2 +2	2 x 15 x 0.04	1.2
		<b>Gjithsej</b>	9
<b>1.2. Viti akademik 2020/2021</b>			
	Financat e korporatave (Ekonomik: Financa-kontabilitet) Sem. VII	2 x 15 x 0.04	1.2
	Analiza e raporteve financiare (Ekonomik: Ekonomi-biznes), Sem. VII 2 +2	2 x 15 x 0.04	1.2
	Bankat dhe punët bankare (Ekonomik: Financa-kontabilitet), Sem. V 2 +2	2 x 15 x 0.04	1.2
	Teoria dhe analiza e bilancit (Ekonomik: Financa-kontabilitet), Sem VII 2 +2	2 x 15 x 0.04	1.2
	Menaxhimi bankar (Ekonomik: Ekonomi-biznes) Sem. VIII 2+2	2 x 15 x 0.04	1.2
	Analiza e raporteve financiare (Ekonomik: Financa-kontabilitet), Sem. VII 3 +2	3 x 15 x 0.04	1.8
	Tregjet dhe institucionet financiare (Ekonomik: Financa-kontabilitet), Sem. VIII 2 +2	2 x 15 x 0.04	1.2
		<b>Gjithsej</b>	9
	Mbajtja e ligjëratave në ciklin e dytë		
<b>2.1.</b>	<b>Viti akademik 2016/2017</b>		
	Tregjet financiare ndërkombëtare	20 x 0.05	1
	Financat ndërkombëtare dhe bankat	20 x 0.05	1
			2
<b>2.1.</b>	<b>Viti akademik 2017/2018</b>		
	Tregjet financiare ndërkombëtare	20 x 0.05	1
	Financat ndërkombëtare dhe bankat	20 x 0.05	1
			2
<b>2.1.</b>	<b>Viti akademik 2018/2019</b>		
	Punët bankare bashkëkohore	20 x 0.05	1
	Tregjet financiare ndërkombëtare	20 x 0.05	1
			2
	Mbajtja e ligjëratave në ciklin e tretë		
<b>3.1.</b>	<b>Viti akademik 2018/2019</b>		
	Trendët bashkëkohore bankare	<b>10 x 0.06</b>	0.6
	Politika monetare	<b>10 x 0.06</b>	0.6
			1.2
	Konsultime me studentë	Poenët	
	Bazat e ekonomisë	85 x 4 x 0.002	0.68

	Bazat e ekonomisë Shkup	85 x 2 x 0.002	0.34
	Mikroekonomi I	85 x 4 x 0.002	0.68
	Bankat dhe punët bankare	55 x 5 x 0.002	0.55
	Financat e korporatave	45 x 5 x 0.002	0.45
	Menaxhmenti financiar	85x2x0.002	0.34
	Vendosje biznesore	85x2x0.002	0.34
	Menaxhimi bankar	45 x 5 x 0.002	0.45
	Tregjet dhe institucionet financiare	45 x 2 x 0.002	0.18
	Analiza e raporteve financiare	45 x 4 x 0.002	0.36
	Teoria dhe analiza e bilancit	45 x 2 x 0.002	0.18
		<b>Gjithsej</b>	<b>4.55</b>
<b>] Mentor i temave të diplomës</b>			
	Tema diplome	47 x 0.2	9.4
<b>Mentor i Temave të magjistraturës</b>			
	Tema të magjistraturës	16 x 2	32
<b>Anëtar i komisionit për mbrojtje të temave të diplomës</b>			
	Komision për tema diplome	34 x 0.2	6.8
<b>Anëtar i komisionit për mbrojtje të temave të magjistraturës</b>			
	Komision për tema magjistrature	29 x 1	29
<b>Libra universitar me recension të botuar</b>			
	<b>Afrim Alili, Liza Alili Sulejmani</b> <b>Bankat dhe Punët bankare, 2020</b>		7
<b>]</b>	<b>Liza Alili Sulejmani, Afrim Alili</b> <b>Mikroekonomi, 2020</b>		7
			14
<b>Libra universitar të botuar me recension, Praktikum</b>			
<b>Viziting profesor jashtë vendit</b>			
	Viziting profesor jashtë vendit Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2016/2021	5 x 2	10
<b>Skripta të brendshme për ligjërata</b>			
	Analiza e pasqyrave financiare	1 x 4	4
	Menaxhmenti financiar	1 x 4	4
	Financat e korporatave	1 x 4	4
	Teoria dhe analiza e bilancit	1 x 4	4
	Financat e korporatave për informatikë	1 x 4	4
			20
<b>Gjithsej</b>			<b>184</b>

## II. VEPRIMTARIA SHEKNCORE-HULUMTUESE

Nr.rendor	Emri i aktivitetit:	Poenët	
	II. Teza të mbrojtura		
II.1	“Teknologjitë e internetit për përkrahje informative të ndërmarrjes ALFA”, Shën Shën Kirili dhe Metodi, V. Turnovo, 2003		
II.2	“Menaxhimi me rrezikun e kredisë në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë”, Shën Shën Kirili dhe Metodi, V. Turnovo, 2009		
	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë shkencore/profesionale</b>		
II.3	Alili Imërlije, <b>Alili Afrim</b> , Relationship between water pollution and economic growth in Republic of Kosova, International journal “Knowledge”, Vol.43.3, ISSN: 1857-923X (Printed), ISSN : 2545-4439 (Online), pp.515-521, 2020	6 x 0.8	4.8
II.4	Alili Sulejmani, Liza, Velickovska, Kristina & <b>Alili, Afrim</b> : The macroeconomic approach of the Pandemic COVID - 19, Trends in Economics, Finance and Management Journal, Vol. 2, Issue 1, 2020.	6 x 0.8	4.8
	Alili Sulejmani, Liza & <b>Alili Afrim</b> : The nexus between institutional factors and foreign direct investments in developing countries in Europe, Knowledge International Journal 31 (1), 23-26, 2019	6 x 0.8	4.8
	Alili Sulejmani, Liza, <b>Alili, Afrim</b> : Nexus trade openness, FDI and economic growth in Republic of Macedonia: VECM approach, InTraders International Conference on International Trade Conference Book, pp. 500 – 512, 2018.	6 x 0.8	4.8
	Alili Sulejmani, Liza., Bilic, Snezana & <b>Alili, Afrim.</b> : “The Impact of Distortionary Taxes on Economic Growth: Case of Republic of Macedonia”, International journal “Knowledge”, Vol.20.1, ISSN2545 – 4439, ISSN 1857 923X, pp.483-486, 2017.	6 x 0.8	4.8
	<b>Alili, Afrim</b> , Alili Sulejmani, Liza, & Krалеva,	6 x 0.9	5.4

	Natasa.: “Econometric Analysis of the Impact of Productive and Unproductive Expenditures on Economic Growth: Case of Republic of Macedonia, International journal “Knowledge”, Vol.20.1, ISSN2545 – 4439, ISSN 1857 923X, pp.253-259, 2017.		
	Alili Imërlije, <b>Alili Afrim</b> , Effects of climatic change factors in agricultural production Case of Republic of Macedonia, Interntional Journal Institute of Knowledge Management, Vol. 20.5, Skopje, 2017	6 x 0.8	4.8
	<b>Alili, Afrim</b> , Relationship and causality between interest rate and inflation rate: Case of Republic of Macedonia, International Journal Scientific Papers, Knowledge, Vol. 15.3, Skopje, 2016	6 x 1	6
			64.2
	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë profesionale/shkencore</b>		
II.6			
	<b>Abstrakte të publikuar në librin e përmbledhjeve të konferencave ndërkombëtare</b>		
II.8	<p>Contemporary Economic Trends” – CET2019, organized by: Faculty of Economics &amp; Faculty of Business Administration, University of Tetova, 13 – 15 November, 2019 at University of Tetova, Macedonia.</p> <p>InTraders International Conference on International Trade, The impact of the variability of requiremnt reserves on banking system financial intermediation, 04-06 October 2018, Sakarya, Turkey</p> <p>Konferenca e 11 shkencore, Kolegji Biznesi, Marrëdhënia dhe ndërveprimi midis zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit të emergjencave, Menaxhimi emrgjen me efektet e zhvillimit ekonoomik dhe ndotjen e mjedisit ujqor në Republikën e Kosovës, Prishtinë, 25. 10.2018]</p>	10 x 1	10

	<p>InTraders International Conference on International Trade, 10-12 May 2018, Sakarya, Turkey</p> <p>Effects of climatic change factors in agricultural production Case of Republic of Macedonia, Knowledge in Practice, Eleventh International Scientific Conference, Bansko, 15-17 December 2017</p> <p>ICOS2017, International Conference on Official Statistics, Sarajevo, BiH, Causal impact of Public Revenues and Public expenditures in Republic of Macedonia, Sarajevo, March 2016, Bosnia and Hercegovina</p> <p>Knowledge in Practice, Eleventh International Scientific Conference, Relationship and causality between interest rate and inflation rate: Case of Republic of Macedonia, Bansko, 16-18 December 2016</p> <p>Efektet e proceseve migruese në Ballkanin Perëndimor, Konferenca e katërt shkencore e Fakultetit Ekonomik, 02 Dhjetor, USHT, Tetovë 2016</p> <p>Challenges of doing business in the contemporary World, Konferenca e pestë shkencore e Fakultetit Ekonomik, USHT, Tetovë 2017</p> <p>Economic development as prediction for EU integration, Konferenca e gjashtë shkencore e Fakultetit Ekonomik, USHT, Tetovë 2018</p>		
	<b>Gjithsej</b>		<b>74.2</b>

### III. VEPRIMTARIA PROFESIONALE –APLIKATIVE

Nr.rendor	Emri i aktivitetit:	Poenët	
	III. Koordinator për përgatitjen e elaboratit për program të ri studimor Për vitet akademike 2016/2017		

	2017/2018 2018/2019		
III.1	Studime të ciklit të parë	2 x 1	2
III.2	Studime të ciklit të dytë	2x 1	2
III.3	Studime të ciklit të tretë	2 x 1	2
			6
	Aktivite të eksperte: evaluimi, revizion profesional, mbikëqyrje, vlerësimi i kapitalit, sistematizim, metodologji		
III.3	Anëtar i komisionit për evaluim të Universitetit të Tetovës 2016/2017	1 x 1	1
III.4	Pjesëmarrje në aktivitetet promotive të fakultetit/institutit		
III.5	Promovim i Fakultetit ekonomik për vitet akademike: 2016/2017 2017/2018	2 x 1	2
III.6	Redaktim shkencor i librave të botuar të përkthyer në gjuhën shqipe		
	Shtëpia botuese ARS Studio, Shkup	2 x 1	2
	<b>Gjithsej</b>		<b>11</b>

#### IV. VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJËRË

Nr.rendor	Emri i aktivitetit:	Poenët	
	IV. Anëtar i këshillit organizues të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare		
IV.1	Anëtar i këshillit organizues të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare të Fakultetit Ekonomik Për vitet akademike 2016/2017 2017/2018	2 x 1	2
	Anëtar i Komisionit Universitar		
IV.2	Anëtar i komisionit për rangim të studentëve në nivel universitar Për vitet akademike 2016/2017 2017/2018 2018/2019	3 x 1	3
	Anëtar i komisionit të Fakultetit		
IV.3	Anëtar i komisionit të Fakultetit Ekonomik për ciklin e parë të studimeve dhe për ciklin e dytë Për vitet akademike 2016/2017	3 x 1	3

	2017/2018 2018/2019		
	Anëtar i Komisionit për zgjedhje në thirrje		
IV.4	Komisione recensuese për zgjedhje në thirrje docent	6 x 0.5	3
IV.5			
	Qëndrim studimor		
IV.6	Qëndrim studimor, Universiteti i Zagrebit, Opatijë, Kroaci, 7 ditë, Shtator 2018	1 x 1	1
VI.7	Përgjegjës i programit studimor Master		
	Përgjegjës i Ciklit të dytë të studimeve / Master 2016/2017	1 x 1	1
	<b>Gjithsej</b>		<b>13</b>

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATES PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE</b>	<b>PIKË</b>
VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	184
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	74.2
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	13
VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJËRË	11
<b>Gjithsej</b>	<b>282.2</b>

Tetovë, Dhjetor 2021

Komisioni recenzues:

1. Prof. Dr. Ibish Mazreku

---

2. Prof. Dr. Alifeta Selimi

---

3. Prof. Dr. Sabahudin Komoni

---



**Raport i Komisionit recensues për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Marketing menaxhment, Marketingu i turizmit dhe Marketing (50608, 51414, 50325 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), drejtuar Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tetovës.**

Ne bazë të konkursit të shpallur më datë 30 nëntor të vitit 2021, në gazetata ditore “Koha” dhe “Sloboden pečat”, Këshillit mësimor shkencor i Fakultetit Ekonomik në mbledhjen e mbajtur më 16 dhjetor 2021, sjell Vendim për formim të Komisionit recensues me nr. 14-1241/3, për zgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Marketing menaxhment, Marketingu i turizmit dhe Marketing (50608, 51414, 50325 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

- 1. Prof.Dr. Etem Iseni**, Profesor ordinar, Fakulteti ekonomik, Universiteti i Tetovës,
- 2. Prof.Dr. Sofronija Miladinovski**, Profesor ordinar, Fakulteti i turizmit në Ohër,
- 3. Prof.Dr. Katerina Angelevska-Najdeska** Profesor ordinar, Fakulteti i turizmit në Ohër,

Pas pranimit të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni në fjalë vërtetoi se në konkurs është paraqitur vetëm një kandidat:

- 1. Prof.Dr. Raman Ismaili**, me Fletë aplikimi nr. 04/15/14. të datës 03.12. 2021.

Komisioni pasi që konstaton se dosja e aplikimit përmban të gjithë dokumentacionin e rregullt të paraparë në konkurs, paraqet:

**Raport recensues**

Me datë 30.11.2021, në gazetata ditore “Koha” dhe “Sloboden pečat” është shpallur konkurs për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi në Fakultetin Ekonomik në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Marketing menaxhment, Marketingu i turizmit dhe Marketing (50608, 51414, 50325 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

Bazuar në dokumentacionin e pranuar, të kandidatit **Prof.Dr. Raman Ismaili**, komisioni paraqet referat me të dhëna si më poshtë;

**1. Të dhëna biografike**

**Raman Ismaili** është i lindur më 25.01.1966 në fshatin Sellarcë të Epërme të Tetovës. Shkollimin fillor e ka kryer në fshatin e lindjes. Shkollimin e mesëm e mbaron në vitin 1985, si nxënës i shkëlqyer në Gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” të Tetovës, drejtimi i Përgjithshëm. Më pastaj në vitin 1989 mbaron edhe shkollën e dytë të mesme, Shkollën profesionale „Mosha Pijade„ Tetovë, drejtimi i Hotelierisë.

Studimet bazike i kryen në Fakultetin e Turizmit dhe hotelierisë në Ohër, pranë Universitetit “Shën Klimenti i Ohrit”, në Manastir dhe fiton titullin „*Menaxher i diplomuar në fushën e turizmit,*„

Po në të njëjtin institucion në vitin 2007 regjistron studimet e magjistraturës. Pasi që përfundon provimet (mesatare 9.33), kandidati me sukses mbron temën e magjistraturës me titull: „*Strategjia e marketingut për plasmanin e produktit hotelier në rajonin e Strugës,*„ dhe fiton gradën shkencore „*Magjistër i shkencave në fushën e turizmit dhe hotelierisë,*„

Në vitin 2011, kandidati në Fakultetin e Turizmit në Ohër me sukses mbron disertacionin e doktoratës, me titull: „Çmimet si përcaktues të avantazhit konkurrues të ndërmarrjeve hoteliere të rajonit të Ohrit dhe Strugës, dhe fiton gradën shkencore „Doktor i shkencave në fushën e Turizmit dhe hotelerisë,„

Kandidati **Prof.Dr. Raman Ismaili** me Vendim nr. 04-4319/1, të datës 27 Tetor të vitit 2016, është zgjedhur në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar**, e që nga viti 2010 vazhdon të jetë në marrëdhënie të rregullt pune në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës.

## 2. Mësimdhënia dhe veprimtaria arsimore

Angazhimi në mësimdhënie dhe veprimtari arsimore i kandidatit **Prof.Dr. Raman Ismaili** është tejet i begatshëm. Në fakt, në mësimdhënie është i përfshirë në të tri ciklet e studimit, brenda dhe jashtë vendit, Në ciklin e parë të studimeve në Fakultetin ekonomik të Universitetit të Tetovës, kandidati ka realizuar një fond të konsiderueshëm të leksioneve në lëndët Bazat e marketingut, Marketingu i turizmit, dhe Biznesi ndërkombëtar. Në cilësinë e Profesorit vizitor, në Fakultetin e Suboticës, në departamentin e Bujanocit, ka ligjëruar lëndët Ekonomia ndërkombëtare dhe Ekonomia e ndërmarrjes. Në vazhdimësi, kontributi i kandidatit në mësimdhënie ka vazhduar edhe në ciklin e dytë të studimeve, ku ka realizuar leksione në lëndët Marketing menaxhmenti bashkëkohor, Strategjitë e marketingut ndërkombëtar, Liderhipi dhe ndryshimet organizative dhe Marketingu strategjik i avancuar. Nga të dhënat e mësipërme, rezulton të jetë realizuar një gamë e gjerë në fusha të ngushta lëndore, ku kandidati ka kontribuar në përgatitjen profesionale të studentëve.

Përpos mësimdhënies, në veprimtarinë arsimore kandidati ka realizuar obligime pedagogjike siç janë konsultat me student; udhëheqje shkencore në nivele të Studimeve deridiplomike, pjesëmarrje në vlerësim dhe mbrojtje të temave në Studimet Master; udhëheqje shkencore në nivel të Studimeve Master, pjesëmarrje në vlerësim dhe mbrojtje të temave në Studime të doktoratës. Ai gjithashtu është anëtar i Komisioneve recensuese për zgjedhje-rizgjedhje për bashkëpunëtor dhe mësimdhënës. Gjithashtu, është një nga recensentët të tekstit Universitar „Qeverisja e korporatave,“ të autorit Prof.dr. Brikend Aziri, i botuar nga Qendra e botimeve të Universitetit të Tetovës në vitin 2020. Vlen të përmendet se me Vendim të Senatit të Universitetit të Novi Sadit, nr. 08-2863, të datës 29.09.2019, **Prof.Dr. Raman Ismaili** është zgjedhur në thirrje **Profesor vizitues**.

Në bazë të kriterëve për vlerësimin e arritjeve të kandidatëve për zgjedhje dhe rizgjedhje, si pjesë përbërëse e Rregullores mbi kriteret dhe procedurën për zgjedhje dhe rizgjedhje në thirrje mësimore/shkencore, kandidati **Prof.Dr. Raman Ismaili** në veprimtarinë e mësimdhënies dhe asaj arsimore, ka grumbulluar gjithsej **103,3 pikë**.

## 3. Veprimtaria shkencore/hulumtuese

Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit **Prof.Dr. Raman Ismaili** përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare si dhe me pjesëmarrje në tubime të ndryshme shkencore dhe profesionale. Kjo veprimtari kryesisht është përfshirë si më poshtë:

1. Punime të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare (ISSN),

